



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality

01 Nr.060/1-12222/1

Dt.06/08/2020

Dragash

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), lidhur me nenin 28 dhe 29, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 4, nenit 5, lidhur me nenin 8 pika 2, të Ligjit Nr-04/L-010 për bashkëpunim ndër-komunal, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 7/2011”, nenit 32 të Statutit të Komunës së Dragash-it Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës së Dragash-it, në seancën e 8 (tetë) të rregullt të mbajtur më datë 06/08/2020, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

1. **MIRATOHET** Marrëveshja për bashkëpunim ndër-komunal, me numër të protokollit 02 Nr.560/01-8839/20 e datës 18.06.2020 e nënshkruar nga Kryetaret e Komunave të Republikës së Kosovës si vijonë:

- 1.1 Komunes së Dragashit të Republikës së Kosovës
- 1.2 Komunes së Prizrenit të Republikës së Kosovës
- 1.3 Komunes së Suharekës të Republikës së Kosovës dhe
- 1.4 Komunes së Mamushes të Republikës së Kosovës

2. Marrëveshja për bashkëpunim ndër-komunal, është në kuadër të kompetencave të tyre vetanake me qëllim të ushritit më efikas dhe më efektiv të detyrave vetanake, konkretisht financimin e “Qendrës për strehimin e grave dhe fëmijëve”.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është marrëveshja për bashkëpunim ndër-komunal, me numër të protokollit 02 Nr.560/01-8839/20 e datës 18.06.2020 e nënshkruar nga 4, (katër) Kryetaret e Komunave, përfaqësues të institucioneve shtetërore të nivelit lokal, të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Dragashit.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Dragash, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008”), nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Betim Merdiu